



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 60/01-36350/21
Kaçanik, 08.12.2021

Në bazë të Vendimit për Certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale 2021, Nr. 3189/2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për Kryetar Komune në Kaçanik, pas dhënies së Betimit dhe Nënshkrimit të Deklaratës Solemne të Kryetarit të zgjedhur të Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi sipas nenin 57.1 të LVL, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 08 Dhjetor 2021, vendosi të bëjë:

**INAUGURIMIN (KONSTITUIMIN) E KRYETARIT TË
KOMUNËS SË KAÇANIKUT, BESIM ILAZI**

(i zgjedhur në Zgjedhjet Lokale të 17 Tetorit 2021, në Rundin e dytë të votimit të datës 14 Nëntor 2021)

1. Me këtë Vendim, INAUGUROHET (KONSTITUOHET) Organi më i Lartë Ekzekutiv i Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës, BESIM ILAZI, nga subjekti politik i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së), i zgjedhur në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 17 Tetor 2021- respektivisht në Rundin e dytë të votimit me 14 Nëntor 2021, për me udhëhequr Komunën e Kaçanikut, për mandat 4 vjeçar.
2. Kryetari i zgjedhur i Komunës së Kaçanikut, me dhënien e Betimit dhe Nënshkrimit të Deklaratës Solemne para Kuvendit të Komunës dhe qytetarëve të kësaj komune, ngarkohet me përgjegjësi për ta përfaqësuar Komunën e Kaçanikut, vepruar në emër të saj, dhe përgjegjësitë tjera të përcaktuara si në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Akteve tjera nënligjore.
3. Kryetari i zgjedhur i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të rundit të dytë të votimit të datës 14 Nëntor 2021, respektivisht pas dhënies së betimit për Kryetar komune, e merr zyrtarisht detyrën për të udhëhequr më Komunën e Kaçanikut për mandat 4 vjeçar, ndërkaq e përfundon sipas nenit 56.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
4. Kompensimi për Kryetarin e zgjedhur të Komunës, rregullohet më Akt të veçantë në pajtim me Udhëzimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, Udhëheqësi i Personeli, dhe Arkivi.

Kryesuesi i Mbledhjes
Kadri Krivenjeva





Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Data	07.12.21	Vendi	BAZAR
Uj. org.	Numri	Shtojcë	
01	06062-37337	-	

Bazuar në nenin 57 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kryetari i zgjedhur i Komunës, e jep Betimin ose Deklaratën Solemne, para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në mbledhjen Inauguruese të Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 08 Dhjetor 2021, si në vijim.

BETIM

Unë, BGSIM QAMIL ILAZI, “Betohem (ose deklaroj solemnisht) që do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtrojë kompetencat si Kryetar i Komunës së Kaçanikut, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t’i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë”.

Vendi, Kaçanik

Datë, 08.12 2021

Emri dhe mbiemri i Kryetarit të Komunës së Kaçanikut

BGSIM Q. ILAZI Nënshkrimi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



I	Data	26.11.2021	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numi	60/01-36350-1	Shtojcë	

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E KACANIKUT
OPSTINA KACANIK

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 106.1, 106.3 dhe 106.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenin 26 të Ligjit nr. 03/L-072 të për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 23.11.2021, nxjerrë këtë:

VENDIM

Për Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale 2021 të Raundit të Dytë për Kryetar Komune në Kaçanik

Pas përfundimit të të gjitha procedurave në Vendvotime dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe nga Gjykata Supreme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Certifikon Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve për Kryetar Komune të Raundit të Dytë në Kaçanik, të mbajtura me datën 14.11.2021.

- II. Kryetar Komune në Kaçanik, është zgjedhur Besim Ilazi, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës - PDK, me 7,373 vota, në përqindje prej 53,91 %.
- III. Rezultatet e zgjedhjeve si në pikën I, i janë bashkangjitur këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
- IV. Këto rezultate janë përfundimtare dhe detyruese.
- V. Obligohet Sekretariati i KQZ-së që t'i publikojë në formë tabelare rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve në pajtim me këtë vendim.
- VI. Ky vendim, hyn në fuqi me 23.11.2021.


Prishtinë, 23.11.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radonjqi



KACANIK/KACANIK/KACANIK



■ BESIM ILAZI	53.9%
■ JETON RAKA	46.1%
Total:	100.0%

KACANIK/KACANIK/KACANIK				
Emri/ Ime	Mbiemri/ Prezime	Emri i Partisë / Naziv Partije	Votave/Glasova	Përqindja/ Procentat
BESIM	ILAZI	177 PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES	7 373	53,91%
JETON	RAKA	144 LEVIZJA VETEVEDOSJE!	6 304	46,09%



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10, nenin 3.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03L-040, nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 07.12.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.BRAHIM IMISHTI**, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Kaçanik, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Besim Ilazi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-
- III. së, që ky vendim t'i komunikohet z.Brahim Imishti dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 25.11.2021, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Besim Ilazi, me rastin e dorëheqjes së tij, për arsye të marrjes së pozitës Kryetar i Komunës në Kaçanik.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidati në listën e rënditur është z.Brahim Imishti.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 %, të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 07.12.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

